

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, “Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 146, datë 18 korrik 2017, në faqen 6987, bëhet korrigjimi i gabimit material, si më poshtë:

Në nenin 9, germa “d”, “Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor”, pika “iii”:

Ishte: *Garancinë e përshtatshme financiare (neni 4.1/“c” dhe tregtimit (neni 4.1/“ç”) dhe garancinë e performancës që sigurojnë aftësinë e aplikantit për të përmbushur të gjitha detyrimet e tij nën licencën e kërkuar, duke përfshirë, por pa u kufizuar; largimin përfundimtar të plotë ose të pjesshëm të pajisjeve dhe/ose infrastrukturës dhe rehabilitimin e mjedisit, si dhe mbështetjen menaxheriale, operacionale dhe financiare prej pronarëve të aplikantit.*

Bëhet: *Garancinë e përshtatshme financiare [e paaplikueshme për rastin e furnizimit (neni 4.1/“c”) dhe tregtimit (neni 4.1/“ç”)] dhe garancinë e performancës që sigurojnë aftësinë e aplikantit për të përmbushur të gjitha detyrimet e tij nën licencën e kërkuar, duke përfshirë, por pa u kufizuar; largimin përfundimtar të plotë ose të pjesshëm të pajisjeve dhe/ose infrastrukturës dhe rehabilitimin e mjedisit, si dhe mbështetjen menaxheriale, operacionale dhe financiare prej pronarëve të aplikantit.*